<p>Programet për punë të secilit aktiv profesional;</p> <p>Raport nga mbledhjet e aktivitetit profesional;</p> <p>Raportet vjetore të aktiveve profesionale;</p> <p>Trajnimet e arsimtarëve nga ana e BZHA dhe Qendra e provimeve shtetërore;</p>	<p>Përvojat dhe informacionet gjatë planifikimit arsimtarët i shkëmbejnë në nivel të:</p> <p><b>Aktivitet profesional</b></p> <p>Shkëmbimi i përvojave për të realizuar programin mësimor;</p> <p>Shkëmbimi i përvojave në zbatimin e formave dhe metodave interaktive, zbatimi i TIK-ut në mësimdhënie;</p> <p>Realizimi i orëve të hapura;</p> <p>Shkëmbimi i përvojave dhe këshillave për programet për të punuar me nxënësit që kanë vështirësi në të mësuarit e materialit;</p> <p>Ndarja e përvojave dhe programeve të këshillimit për punë me nxënës të talentuar dhe për përgatitjen e tyre për pjesëmarrje në gara;</p> <p><b>Kolegëve nga shkollat e tjera</b></p> <p>Shkëmbimi i përvojave në zbatimin e formave dhe metodave interaktive, zbatimi i TIK-ut në mësimdhënie;</p> <p>Ndarja e përvojave dhe programeve të këshillimit për punë me nxënës të talentuar dhe për përgatitjen e tyre për pjesëmarrje në gara;</p> <p><b>Këshilltarëve nga BZHA dhe Qendra shtetërore të provimeve</b></p> <p>Konsultimi për zbatimin e programit mësimor;</p> <p>Konsultimi mbi zbatimin e formave dhe metodave interaktive, zbatimi i TIK-ut në mësimdhënie;</p> <p>Këshilla për përgatitjen e nxënësve për provimin maturës.</p> <p>Pjesa më e madhe e arsimtarëve përdorin internetin (faqet e internetit dhe forumeve) për ndarjen e përvojave dhe informacioneve me kolegët nga vendet fqinje.</p>

<b>Analiza e lëmisë 3</b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>
<i>Indikatori i cilësisë 3.1</i>	Planifikimi i arsimtarëve
<i>Temat:</i>	Ndihma dhe përcjellja e arsimtarëve gjatë planifikimit
	Planifikimi i individual i arsimtarëve
	Këmbimi i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit
	Renditja e orëve
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjinnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë
<b>Konstatimi i anëve të forta</b>	<b>Konstatimi i anëve të dobëta</b>
Arsimtarët përgatisin planifikim vjetor, tematik dhe tematiko - procesual si dhe përgatitje ditore (në formë të shkruar dhe elektronike)	Në shkollën tonë nuk përcjellen (ose nuk ekzistojnë) planifikimet e arsimtarëve dhe procesit arsimor nga ana e drejtorit, shërbimit profesional dhe/ose personave të autorizuar nga organet profesionale
Pjesa më e madhe e arsimtarëve përgatisin planifikim i cili përmban elemente të nevojshme për realizimin me sukses të procesit arsimor	Mbizotëron arsimim tradicional edhe përkaj planifikimit me format e parapara bashkëkohore, metodave dhe teknikave të mësimit
Si ndihmë për mësimdhënësit (të punësuarit e rinj) emërohen mentorë të cilët e përcjellin punën e tyre	Mjedisi për mësim nuk është gjimone motivues dhe nuk i stimulon nxënësit për mësim përshkak të mungesës së mjeteve mësimore
Është i dukshëm bashkpunimi i arsimtarëve në kuadër të aktiveve profesionale për këmbimin e përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit	Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie në numër të madh të rasteve praktikohet nëpërmjet prezantimeve POWER POINT duke mos shfrytëzuar E përmbajtjet dhe aplikacionet
Planifikimin e orarit mësimor, duke e rrespektuar interesin e nxënësve e përgatit shërbimi profesional ose arsimtari i caktuar nga ana e drejtorit në bashkëpunim me arsimtarët dhe me shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të disponuara të shkollës	Shkolla jonë nuk ka politikë shkollore për vlerësim dhe nuk përgatit kriteriume për vlerësim dhe rezultatet nga vlerësimi nuk i aplikon përparimin e mësimit

	Shkolla nuk bën identifikim e nevojave shkollore për të gjithë nxënësit
Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Të bëhet përcjellja e vazhdueshme e planifikimit dhe realizimit të mësim
	Në procesin mësimor, mësimi tradicional të zëvendësohet me mësim interaktiv
	Të realizohet mësimi në tërësi me shfrytëzimin e TIK - ut dhe të këmbehen përvojat në dhe jashtë shkollës (seminare, trajnime, punëtori, orë të hapura, etj.)
	Të përmirësohet mjedisi për mësim me cka më shumë do të motivohen nxënësit për aritjen e rezultateve më të larta
	Shkolla ë përgatis, të rrespektoj dhe aplokoj standarde për vlerësim
	Me kriteret për vlerësim të njoftohen nxënësit dhe prindërit



<b><i>Analiza e lëmisë 3</i></b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>	
<i>Indikator i cilësisë 3.2</i>	Procesi arsimor	
<i>Temat:</i>	Format dhe metodat mësimore	
	Detyrat e zgjedhura, aktivitetet dhe resurset	
	Interakcioni në mes arsimtarëve dhe nxënësve	
	Afrimi i arsimarit kah nxënësit	
	Përcjellja e procesit mësimor	
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjinnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë	
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>		<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Numri më i madh i arsimtarëve planifikojnë forma mësimore të ndryshme, metoda dhe teknika të nxënies		Numër i vogël i arsimtarëve realizojnë mësimin me planifikim të ndryshëm të formave arsimore, metodave dhe teknikave të mësimit
Pjesa më e madhe e arsimtarëve në lidhje me nxënësit promovojnë rrespekt të ndërsjelltë, ndihmë, bashkëpunim dhe kuptueshmëri dhe nuk bëjnë dallim në mes nxënësve sipas gjinisë dhe prejardhjes sociale të tyre		Zgjedhja e detyrave dhe aktiviteteve jo cdoherë janë të nivelit të ndryshëm të kompleksitetit dhe jo cdoherë janë të përshtatura për nevojat arsimore individuale të nxënësve
		Shkolla nuk ka procedurë interne për përcjelljen e procesit arsimor e cila rregullisht do të aplokohej, ndërsa rezultatet nga përcjellja do të shfrytëzoheshin për përmirësimin e procesit arsimor
Është i dukshëm bashkpunimi i arsimtarëve në kuadër të aktiveve profesionale për këmbimin e përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit		Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie në numër të madh të rasteve praktikohet nëpërmjet prezantimeve POWER POINT duke mos shfrytëzuar E përmbajtjet dhe aplikacionet

Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Realizimi i mësimit me planifikime të ndryshme të formave mësimore, metadave dhe teknikave të mësimit
	Zgjedhja e detyrave dhe aktiviteteve me nivel të ndryshëm të kompleksitetit të cilat janë të prshatura nevojave individuale arsimore të nxënësve
	Të bëhet proceduarë e shkrua interne për përcjelljen e procesit arsimor e cila rregullisht do ë aplikohet, ndërsa konkluzionet nga percjellja e orëve të shfrytëzohen për përmirësimin e procesit arsimor

<b>Analiza e lëmisë 3</b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>
<i>Indikator i cilësisë 3.2.1</i>	Interaktiviteti në mësim
<i>Temat:</i>	Interaksioni në mes arsimtarëve dhe nxënësve
	Interaksioni në mes nxënësve
	Shfrytëzimi i teknikave të ndryshme në mësim
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë
<b>Konstatimi i anëve të forta</b>	<b>Konstatimi i anëve të dobëta</b>
Numër i madh i arsimtarëve planifikojnë mësim interaktiv duke përfshirë forma interaktive, metoda dhe teknika të të nxënit	Një pjesë e vogël e arsimtarëve e realizojnë mësimin me forma interaktive, metoda dhe teknika në mënyrë aktive duke përfshirë nxënësit në interaktivitet në mes tyre në procesin mësimor
	Interaktiviteti në mes arsimtarit - nxënësit, nxënës - nxënës në pjesë të vogël aplikohet gjatë realizimit të procesit arsimor
	Një pjesë e vogël e arsimtarëve shfrytëzojnë teknika të ndryshme të mësimit dhe janë të njohura në cilat pjesë dhe në cilat përmbajtje mësimore mund t'i aplikojnë
Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Realizimi mësimor me aplikimin e formave interaktive, metodave dhe teknikave me përfshirjen aktive dhe interaktivitet në mes tyre në procesin mësimor
	Të organizohen trajnime interne dhe eksterne nga provajder (ofrues) të autorizuar dhe persona profesional për aplikimin e teknikave të ndryshme të mësimit në procesin mësimor

<b><i>Analiza e lëmisë 3</i></b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>
<i>Indikator i cilësisë 3.2.2</i>	Shfrytëzimi i TIK-ut në mësim
<i>Temat:</i>	Përdorimi i TIK-ut në mësim
	Shfrytëzimi i aplikacioneve të gatshme dhe përpunimi i atyre personale gjatë realizimit të mësimin
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>	<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Pjesa më e madhe e arsimtarëve janë të trajnuar për përdorimin e TIK-ut dhe aplikimin e tenologjive te reja arsimore në mësim	Mungesa e aplikacioneve të përshtatshme dhe e-përmbajtjeve të disponueshme në disa lëndë mësimore
Arsimtarët në planet ditore dhe tematike planifikojnë shfrytëzimin e TIK-ut gjatë realizimit të përmbajtjeve të caktuara mësimore	Pjesë e vogël e arsimtarëve shfrytëzojnë aplikacione të përshtatshme dhe e-përmbajtje nga faqet e disponueshme të internetit
Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Sigurimi i aplikacioneve të përshtatshme dhe e-përmbajtjet e disponueshme nga të gjitha lëndët mësimore
	Shfrytëzimi i aplikacioneve dhe e-përmbajtjeve të disponueshme nga faqet e internetit nga të gjithë arsimtarët

<b>Analiza e lëmisë 3</b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>
<i>Indikator i cilësisë 3.2.3</i>	Interaksioni i arsimimit ekologjik
<i>Temat:</i>	Plani i veprimit për zbatimin e projekteve ekologjike dhe pikat e aksioneve të eko-standardeve të përcatuara
	Integrimi përmbajtjeve ekologjike në programin vjetor të punës së shkollës dhe përfshirja e përmbajtjes ekologjike në planifikimin individual të mësimdhënësve sipas programit ekologjik
	Vëllimi dhe diversiteti, përfshirja, barabarsia, përfshirja dhe afirmimin e nxënësve (të gjinive, etnisë, gjuhës, nevojave të veçanta arsimore të ndryshme) në përgatitjen e analizës së gjendjes së mjedisit dhe planit të veprimit për zbatimin e projekteve ekologjike dhe pikat e veprimeve të vendosur të eko-standardeve
	Ndërveprimi mes arsimatrëve dhe nxënësve dhe inkurajimi i nxënësve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e projekteve ekologjike dhe pikat e pjesës nga eko-standardeve e përcaktuara
	Zbatimi i një pike të veprimit në lidhje me shëndetin në përputhje me eko-standartet e caktuara (sigurimin dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe të pastër për të punuar dhe mësuar)
	Realizimi i hapit të shtatë të programit ekologjik (Miratimi i eko-kodeksit)
	<i>Shkolla</i>
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>	<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Në shkollën tonë ka një plan të veprimit për zbatimin e projekteve ekologjike dhe pikat e pjesës nga eko-standartet e përcaktuara	Përfshirje më e madhe e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve ekologjike dhe pikat e pjesës nga eko-standartet e përcaktuara të eko-programit

Ekziston bashkëpunimi dhe përfshirja e mësuesve, nxënësve, prindërve dhe partnerëve socialë në përgatitjen dhe zbatimin e eko-programit	
Organizimi i seminareve, projekteve dhe veprimeve në mbështetje të standardeve të eko-programit për sigurimin dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe të pastër për të punuar dhe mësuar	
Shkolla ka miratuar eko-kodeksin	
Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve ekologjike dhe pikat e pjesës nga eko-standardet e përcaktuara të eko-programit

<b>Analiza e lëmisë 3</b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>	
<i>Indikatori i cilësisë 3.3</i>	Përvoja e nxënësve nga mësimi	
<i>Temat:</i>	Mjedisi për mësim	
	Atmosfera për mësim	
	Inkurajimi i nxënësve për të marrë përgjegjësi	
	Ndërveprimi i nxënësve me njëri-tjetrin dhe me më të rriturit në shkollë	
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë	
<b>Konstatimi i anëve të forta</b>		<b>Konstatimi i anëve të dobëta</b>
Në shkollë punimet e nxënësve, ekspozohen në vende të dukshme dhe të përshtatshme në klasat dhe hapësirat e tjera në shkollë		Klasat dhe hapësirat tjera në shkollën tonë, nxënësit pak i përjetojnë si mjedis stimulues dhe motivues të cilat nxisin interes për mësim
Shumica e nxënësve kanë mundësi për të ekspozuar punimet e tyre		Vetëm një pjesë e nxënësve marrin pjesë në të gjitha aktivitetet gjatë orës
Shumica e nxënësve konsiderjnë atë çfarë kanë mësuar si interesante dhe se është e zbatueshme, e dobishme dhe e lidhur me jetën e përditshme		Shumica e nxënësve mendojnë se mendimi i tyre nuk është marrë parasysh në zgjidhjen e problemeve të caktuara dhe sjelljen e vendimeve për to
Nxënësit mendojnë se ata kanë mundësinë për të shprehur mendimet e tyre		
Në shkollë, nxënësit janë të përfshirë dhe punojnë së bashku në projekte të ndryshme të cilat nxisin për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin në mes nxënësve dhe më të rriturve në shkollë		

Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Përmirësimi i kushteve në klasat dhe hapësirat e tjera në shkollë që nxënësit t'i perceptojnë si një stimulues dhe mjedis motivues, që do të rrisë interesin e tyre në mësim
	Përfshirja e të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë në të gjitha aktivitetet gjatë orës
	Përfshirje më e madhe e nxënësve dhe të bashkësisë së nxënësve në zgjidhjen e problemeve të caktuara dhe sjelljen e vendimeve mbi to



<b><i>Analiza e lëmisë 3</i></b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>
<i>Indikator i cilësisë 3.4</i>	Kënaqja e nevojave të nxënësve
<i>Temat:</i>	Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve
	Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>	<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Mangësitë dhe pengesat e identifikuar në procesin e të mësuarit të nxënësve janë hequr duke mbajtur mësim plotësues	Shkolla nuk ka një sistem apo një qasje / procedurë të parashikuar për identifikimin e nevojave arsimore dhe pengesat në procesin e të mësuarit të nxënësve bashkë me nevoja të veçanta arsimore nga arsimtarët dhe shërbimet profesionale
Në procesin e mësimdhënies, shumica e arsimtarëve planifikojnë teknika të ndryshme interaktive të mësimdhënies dhe të të nxënit	Në procesin e mësimdhënies një pakicë e arsimtarëve përdorin një shumëllojshmëri të teknikave interaktive të mësimit dhe mësimdhënies
Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Të ndërtohet një sistem ose qasje / procedurë të përcaktuar për identifikimin e nevojave arsimore dhe pengesav në procesin e të mësuarit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nga shërbimi profesional dhe kuadri mësimdhënës
	Të ndërtohet një sistem ose qasje / procedurë të përcaktuar për identifikimin e nevojave arsimore dhe pengesav në procesin e të mësuarit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nga shërbimi profesional dhe kuadri mësimdhënës

<b>Analiza e lëmisë 3</b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>	
<i>Indikatori i cilësisë 3.5</i>	Vlerësimi si pjesë e mësimi	
<i>Temat:</i>	Politika e shkollës për vlerësim	
	Metodat dhe format e vlerësimit	
	Përdorimi i të dhënave nga vlerësimi në mësimdhënie	
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë	
<b>Konstatimi i anëve të forta</b>		<b>Konstatimi i anëve të dobëta</b>
Shkolla zbaton ligjet dhe rregulloret ekzistuese që rregullojnë vlerësimin e nxënësve në arsimim të mesëm		Në shkollë nuk janë vendosur në vende të dukshme rregulloret dhe kodeksi për vlerësim
Shkolla ka zhvilluar rregullore dhe kodeks për vlerësim		Numër i madh i prindërve theksojnë se nuk janë të njoftuar me rregulloren dhe kodeksin për vlerësim
Shumica e arsimtarëve i zbatojnë kriteret dhe standardet e vlerësimit		Një numër i vogël i arsimtarëve përdorin një shumëllojshmëri të teknikave të vetë-vlerësimit
Shumica e arsimtarëve u japin nxënësve informacione kthyes në lidhje me punën e tyre		Një numër i vogël i arsimtarëve informacionet e marra nga vlerësimi i përdorin për të përmirësuar planifikimin dhe zbatimin e tyre në mësim
Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta		Rregullorja dhe kodeksi i përgatitur për vlerësim të vendoset në vend të dukshëm dhe të njoftohen të gjithë nxënësit dhe prindërit
		Arsimtarët gjatë procesit arsimor, të shfrytëzojnë teknika të ndryshme të vlerësimit dhe vetë-vlerësimit
		Informacionet e marra nga vlerësimi i arsimtarëve, të përdoret për të përmirësuar planifikimin dhe zbatimin e mësimi

<b><i>Analiza e lëmisë 3</i></b>	<b>Mësimi dhe të mësuarit</b>
<i>Indikator i cilësisë 3.6</i>	Informimi për përparimin e nxënësve
<i>Tema:</i>	Informimi i prindërve për përparimin e nxënësve
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” - Kumanovë
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>	<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Shkolla i njofton prindërit për përparimin e nxënësve	Një numër i vogël i prindërve marrin pjesë në mbledhjet prindërore
Prindërit marrin fletët evidentuese për suksesin e arritur të nxënësve	
Nga prindërit kërkohet që t'u jepet informacion kthyes për arritjet e fëmijëve të tyre	
Prindërit mund të shfrytëzojnë mundësinë për të marrë informacion mbi suksesin, rregullsinë dhe përmbajtjet që mësohen përmes e-ditarit	
Rekomandimet për tejkalimin e anëve të dobëta	Të inkurajohen prindërit që të marrin pjesë më shumë në mbledhjet prindërore me cka nëpërmjet kontakteve personale në bashkëpunim me prindërit do të përmirësohet bashkëpunimi dhe do të mundësohet marrja e aktiviteteve adekuate në lidhje me të arriturat dhe përparimin e fëmijëve të tyre

**MJETET E LËMISË:****4. PËRKRAHJA E NXËNËSVE****INDIKATORËT PËR KUALITET**

- 4.1 KUJDESI I PËRGJITSHËM I NXËNËSVE**
- 4.2 SHËNDETI**
- 4.3 KËSHILLAT NDIHMËSE PËR NXËNËSIT PËR VAZHDIMIN E MËTUTJESHËM TË SHKOLLIMIT**
- 4.4 NDJEKJA E PËRPARIMEVE**

Shkolla ka sistem mirë të zhvilluar në notimin e drejtë të të arriturave të nxënësve dhe mundëson plotësimin e nevojave për dituri të nxënësit me paradispozita dhe aftësi të ndryshme.

Shkolla inkurajon te nxënësit ndjenjë për vetëkontrollin e tyre, përgjegjësi dhe pavarësi. Janë të kënaqur nga shkolla dhe mësimdhënia që realizohet në të dhe nga mënyra e sjelljes së mësimdhënësve ndaj tyre.

Aktivitete të ardhëshme; drejtime prioritare në kuadër të kësaj lëmie që mund të jenë të përfshira në planin e zhvillimit të shkollës.

Sigurimi i materialeve dhe mjeteve mësimore.

Transferimi i përvojave të mësimdhënësve të cilët kanë qenë në trajnime me mësimdhënësit e tjerë, si dhe në krijimin dhe zbatimin e risive të qëndrueshme në kushte të vecanta në dispozicion me shkollën.

Trajnimi i mësimdhënësve për të punuar me nxënësit e talentuar, identifikimin, format dhe metodat e punës.

Trajnimi i mësimdhënësve nga shkolla e mesme për të aplikuar teknikat e të mësuarit.

<b><i>Dokumentet e kontrolluara</i></b>	<b><i>Informatat e mbledhura</i></b>
<p>Programi i punës së drejtorit</p> <p>Programi vjetor për punën e shkollës</p> <p>Protokolli për bashkëpunim me nxënësit dhe bashkëpunimit prind-</p>	<p>Drejtori me punën e tij rregullon dhe drejton një kolektiv jashtëzakonisht të madh dhe për këtë planifikon mirë të gjitha punët në shkollë. Bashkëpunimi me kolektivin edhe më shumë ia lehtëson punën. Çdo vit në shkollën tonë aprovet program vjetor i shkollës ku renditen të gjitha organizimet dhe manifestimet të cilat priten të bëhen për atë vit si psh. Organizimi i profesorëve, puna e tyre, ndarja e kolektivit në secilën lëmi, ndarja e detyrave, të arriturat nga secila lëmi, manifestimet e rëndësishme për kolektivin, komunën dhe kombin tonë.</p>

arsimtar	
Mbrojtja nga lëndimet fizike dhe fatkeqësitë elementare	Hapësira shkollore nuk i plotëson nevojat për zhvillimin e mësimit. Shkolla ka rregullore të përcaktuara dhe aktivitete për sigurimin e nxënësve gjatë mësimit në ndërtesën shkollore dhe këto i realizon sipas planifikimit. Nxënësit shfrytëzojnë pajime mbrojtëse gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore për arritjen e shkathtësive praktike. Infrastruktura në shkollë (mobiljet, shkallët, dyshemetë, catitë, dritaret, prizat elektrike, etj) janë të sigurta dhe nuk paraqesin rrezik potencial për lëndimin e nxënësve. Të gjitha vëndet potenciale të rrezikshme në shkollë, që nuk mund të shmangen (pusetat, prizat elektrike, shkallët, hapësirat e rrëshqitshme, etj) dhe nxënësit duhet të kenë vëmendje dhe të jenë të vetëdijshëm për ekzistimin e tyre dhe si të sillen me ato.
Reventiva ndaj dhunës	
Mbrojtja nga konsumimi i duhanit, alkoolit dhe drogës	Shkolla ka kuadër të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, në rast fatkeqësie të nxënësve në shkollë dhe i trajnon të gjithë mësime të nxënësve që të dijnë të gjinden në këto situata. Shkolla ka akte interne për veprim në raste të fatkeqësive elementare dhe së paku një herë në vit simulon gjendje të tillë.
Kujdesi për nxënësit që rrjedhin nga familje me gjendje të vështirë sociale	
Raporti nga kontrolli sistematik për klasat prej vitit të parë deri në vitin e katërt	Shkolla mbanë edhe tribuna ku edhe definojnë të gjitha format e sjelljes së nxënësve dhe të rriturve, të cilët llogariten si dhunë fizike dhe psikike, me theks të veçantë të formave të shqetësimit seksual të nxënësve (mes veti dhe nga ana e të rriturve). Në shkollë ndalohej çfarëdo lloj forme e dhunës e manifestuar nga ana të rriturve dhe nxënësve dhe përcaktojnë mekanizmat për ballafaqimin eventual të dukurive të dhunës me forma të ndryshme. Dokumentin mund ta lexoj çdokush
Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet	
Kujdesi për nxënësit	

me probleme shëndetësore	(mësimdhënësit, nxënësit, prindërit). Të punësuarit e dijnë rolin dhe përgjegjësinë e vet në procesin e mbrojtjes së fëmijës, ndërsa nevojave dhe brengave të fëmijëve iu qasen me kujdes duke u kujdesur për të drejtat, privatësinë dhe dinjitetin e tyre. Aktivitetet për mbrojtje dhe sigurim të nxënësve kordinohen me
Materiali nga puna e këshillit të prindërve	instutucionet e bashkësisë lokale. Viktimat, prindërit e viktimave ose dëshmitarët e dhunës janë të njoftuar me të drejtat dhe procedurat për dhënien e ankesave, në raste të tilla shkolla vepron me kohë dhe pa anime.
Dhënia e ndihmës gjatë zgjedhjes së profesionit për arsim të mëtutjeshëm	Shkolla ka politikën e ndalimit dhe konsumimit të duhanit, alkoholit, dhe distribuimit dhe konsumimit të substancave narkotike, gjë që nënkupton se në shkollë (nëpër klasa, nëpër zyre, tualete, në oborrin shkollor) nuk pihet duhan, nuk vihet në gjendje të dehur dhe nuk konsumohet alcohol si dhe nuk disttribuohet dhe nuk shfrytësohen substance narkoik. Në bashkpunim me bashkësinë locale dhe me komunën shkolla gjen mënyr që të pengoj përdorimin e alkoholit dhe substancave narkotike në hapsirat e saja. Shkolla ka dispozita te shkruara për regjistrimin e dukurive te tilla dhe ndërmer masa kur ato nuk respektohen.
Kujdesi për nxënësit me vështirësi emocionale	
Mbajtja e evidencës së përparimit individual të nxënësve	
Mësimi shtues	
Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve	Shkolla ka dispozita te shkruara për sigurimin e mjeteve material për nxënësit të cilët për shkak të familjeve të tyre në gjendje të vështirë materiale nuk kanë mundësi të ndjekin mësimin me të njejtat kushte si edhe nxënësit e tjerë (psh. Përshkak të mospasjes të librave shkollore dhe mjeteve mësimore) dhe te marrin pjesë në
Evidencë e nxënësve	

Ditari i klasës	aktivitetet e lira në të cilët kërkojnë mjete plotësuese (psh. ekskurziona, shfaqje dhe gara). Dispozitat zbatohen në praktikë për të gjithë nxënësit që rrjedhin nga familje me të ardhura të ulta materiale. Me këtë rast, shkolla bashkëpunon me prindërit, të cilët mundohen shpesh për të gjetur mënyrat si të ndihmohen këta nxënës.
Lista e arsimtarëve kujdestarë të ditës	
Libri kryesor	
Librezat e nxënësve	Kontrolli mjekësor sistematik organizohet çdo vit me vitet e para dhe me vitet e katërta, kjo organizohet në bashkëpunim mes shkollës tonë dhe entin shëndetësor në kuadër të komunës sonë. Bashkëpunimi është në nivel dhe për të gjitha problemet shëndetësore të nxënësve me kohë dhe dokumente paralajmërohet drejtorja e shkollës dhe kujdestarët e klasës. Më vonë lajmërohet edhe prindi të cilit i raportohet për sëmundjet apo problemet që ka hasur mjeku dhe pastaj ai nxënës përcillet në shërim të mëtutjeshëm. Rregullisht bëhet vaksinimi i nxënësve që është e paraparë me rregullën e shkollës njëashtu edhe me Ministrinë Rajonale të Shëndetësisë.
Shënimet nga mbledhjet prindërore	
Dëftesat	
Rregullorja për nxënësit dhe mësimdhënësit	Higjiena e shkollës është në nivel të duhur. Tualetet e mësimdhënësve dhe të nxënësve janë të pastërta dhe të dezinfektura në cdo kohë të ditës. Shkolla kujdeset që nxënësit t'i shfrytëzojnë tualetet në mënyrë të rregullt dhe ta mbajnë higjienën personale. Korridorin dhe shkallët pastrohen më së paku tre herë në ditë, dyshemeja dhe mobiljet në shkollë pastrohen më së paku para fillimit të çdo ndërrimi, hapësira tjetër shkollore së paku një herë gjatë ditës kurse dritaret, dyert dhe inventari tjetër nga dy herë në cdo gjysmëvjetor.



Shkolla ka dispozita të shkruara për kujdesjen e nxënësve të cilët për shkak të sëmundjeve kronike ose lëndimeve serioze mungojnë më gjat nga mësimi i rregullt.

Procedurat zbatohen në praktikë për të gjithë nxënësit që kanë nevojë për një trajtim të tillë. Me këtë rast shkolla bashkëpunon me prindërit, me bashkësinë lokale dhe me institucione të tjera relevante (klinika, ambulanta, qendra për punë sociale).

Këshilli i prindërve në shkollën tonë punon shumë mirë dhe janë të pavarur në punën e tyre për t'i ndihmuar nxënësve, për këtë ata edhe e angazhuan sigurimin fizik në shkollë me pjesëmarrje nga ana e vetë prindërve vetëm e vetëm mos të ketë problem nga jashtë. Ky këshill luan një rol shumë të rëndësishëm në shkollë, sepse çdoherë janë në hap me nxënësit, profesorët dhe drejtorin e shkollës.

Shkolla u siguron nxënësve informata të qarta, të sakta dhe më të reja për mundësit e shkollimit të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim. Për këtë qëllim organizon aktivitete dhe shfrytëzon material promovues të institucioneve arsimore (fletushka, tribuna, vizita nëpër shkolla dhe institucione të arsimit të lartë etj.) për orientim profesional të nxënësve. Përgatitja që e organizon shkolla për zgjedhjen e arsimit të mëtejshëm, të rikualifikimit ose punësimit pas mbarimit të shkollës së mesme përmban një spektër të gjërë të qasjeve mirë të strukturuar: psh. Vlerësim personal i shkathtësive dhe interesave të nxënësve, ndihmë në

hartimin e biografisë së shkurtër, përgatitje për intervistë pune, informim i rregullt i prindërve dhe i nxënësve për ndihmën që mund ta marrin në shkollë, përmes njoftimeve të shkruara dhe gojore nga ana e shërbimeve personale. Shkolla u ofron nxënësve mundësi për organizimin e mirë të punës praktike. Shkolla ka bashkëpunim të rregullt me agjencinë për punësim dhe zbaton rregullisht testime për orientim profesional të nxënësve dhe ju ndihmon për të zgjedhur drejtimin profesional.

Shkolla ka procedura që të zbuloj me kohë dhe të kujdeset për nxënësit me probleme emocionale, pa dallim nga burimet e këtyre problemeve, psh. dhunë familjare, neglizhencë familjare, divorci i prindërve, sëmundje në familje, trauma pas konflikteve). Shërbimi profesional është i trajnuar t'iu ndihmoj nxënësve dhe/ose prindërve në këto situata ose t'i dërgoj në institucione përkatëse. Shkolla ka bashkëpunim të rregullt me institucionet përkatëse siç janë: ambulanta, qendra për punë sociale, policia etj.

Progresi, gjegjësisht të arriturat e nxënësve rregullisht përcillen nëpërmjet mbajtjeve të këshillave arsimore. Prania, gjegjësisht vijueshmëria e nxënësve monitorohet vazhdimisht dhe evidentohet nga ana e profesorëve të lëndës, kujdestarëve dhe prej punëtorëve administrativ. Për nxënësit të cilët mungojnë pa arsye aplikohen masa të duhura pedagogjike. Prindërit e nxënësve të cilët mungojnë pa arsye gjegjësisht i caktohen masa të duhura pedagogjike. Prindërit e nxënësve të cilët kanë rezultate

të zvogëluara në mësim, apo mësimin e vijon në mënyrë jo të rregullt apo nuk sillen mirë në shkollë ftohen për këshillim nga ana e profesorëve të lëndës, kujdestari dhe këshillimin e bën psikologu apo pedagogu i shkollës.

Evidencë për progres dhe vijueshmëri të nxënësve është në dispozicion për të gjitha grupet e interesuara. Për të njëjtën ata njoftohen nga raporti i këshillit të klasës dhe profesorëve, kurse nxënësit dhe prindërit në orët mësimore gjegjësisht në mbledhjet prindërore të mbajtura në ditët e përcaktuara për pranim nga ana e profesorit. Profesorët mbajnë evidencë për të arritura, vijueshmërinë dhe sjelljen e çdo nxënësi (prej vitit të parë deri në të katërtin)

Për nxënësit me njohuri të pa mjaftueshme, shkolla organizon edhe mësim shtues të cilin nxënësin e nxit për të marrë një notë kalues. Kjo ka pasur efekt edhe në vitin e kaluar. Ekziston një bashkpunim i jashtëzakonshëm mes udhëheqësisë së shkollës, shërbimit profesional, kujdestarit të klasës dhe prindërve të cilët çdo tremujorësh mbahen mbledhje dhe informohen për progresin apo ngecjen e nxënësve.

Mësimdhënësit përgatisin raporte dhe analiza të rregullta tremujore për paralelen e tyre, duke u mbështetur në evidencat individuale për nxënësit. Këto raporte dhe analiza të përgatitura për paralelet të veçanta dorëzohen për mbikëqyrje në shërbimin profesional dhe kuadrit udhëheqës dhe mund ti shikojnë të gjithë mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit. Rezultatet nga këto analiza shfrytëzohen për

përmirësimin e procesit edukativo-arsimor.

Nxënësit që bëjnë transferime nga një në shkollë tjetër i lëshohen dokumentet me vulë dhe nënshkrim të drejtorit dhe kujdestarit dhe të evidentuara në protokolin e shkollës.

Në shkollë ekziston një rregull e mirë si rasti i kujdestarisë së mësimdhënësve të cilët për çdo ditë u janë përkushtuar me vëmendje të madhe rendit, vijimit të mësimdhënësve dhe nxënësve dhe pastërtisë brenda dhe jashtë shkollës. Kujdestaria kryhet nga shumica e mësimdhënësve me ndërgjegje.

Bashkëpunimi kolegjial në shkollë është në nivel të lartë për këtë shkak kanë treguar rezultatet e larta në shumë lëmi.

Me kohë kujdestarëve të klasëve ju ndahen ditarë, libri kryesor, librezat dhe dëftesat me qëllim që të ketë kohë të mjaftushme për t'i kryer punët administrative çdo kujdestar i klasës që kërkohen.

Për çdo tremujorësh çdo prind informohet për rezultatet e arritura për fëmijën e tij duke i përgatitur kujdestari i klases dhe në fund të gjysmëvjetorit kujdestari i përgatit librezat. Dëftesat i jep Ministria e Arsimit falas.

Çdo mësimdhënës është i obliguar që në mbledhje prindërore të mbaj protokoll të mbledhjes me pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht të bëjë evidentimin e të gjitha bisedave që bëhen në mbledhje.

	<p>Rregulloret për nxënësit dhe mësimdhënësit janë mirë të përpunuara dhe në çdo klasë janë të varura në murë, ku dalja e nxënësve nga këto rregulle sanksionohen së pari nga kujdestari i klasës, drejtori dhe këshilli i arsimtarëve.</p> <p>Shkolla me gjithë kolektivin arsimor dhe atë profesional cdo herë janë në dispozicion të nxënësve dhe prindërve.</p>
--	---

<b><i>Analiza e lëmisë 4</i></b>	<b>Përkrahja e nxënësve</b>	
<i>Indikatori i cilësisë 4.1</i>	Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit	
<i>Tema</i>	Mbrojtja nga lëndimet fizike dhe fatkeqësive elementare	
	Preventiva nga dhuna	
	Mbrojtja nga duhani, alkooli dhe droga	
	Kualiteti nga ushqimi	
	Përkrahja e nxënësve me të meta fizike	
	Përkujdesja ndaj nxënësve me probleme sociale	
<i>Shkolla:</i>	SHMK Gjumnazi "Sami Frashëri" Kumanovë	
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>		<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Në shumë shkolla ekzistojnë kushte të mira për realizimin e mësimin		Në shkollë nuk ka komision për kontrollimin e kujdesit për kualitetin e ushqimit të nxënësve
Një numër i madh i shkollave ekzistojnë rregullore dhe udhëzime për veprime në raste të fatkeqësive natyrore dhe për atë bëhen simulime për këtë		Në shkollë nuk ka hapësira të përshtatshme për lëvizjen e lirë të nxënësve me të meta fizike
Në shkollë ka njerëz të përgatitur për të ndihmuar		Udhëzime për tejkalimin e

shokët në rastin e fatkeqësive elementare	anëve të dobëta:
Në shkollë nuk ka paraqitje të malltretimeve psikofizike të nxënësve.	Shkollat të udhëheqin kujdes më të madh në kualitetin e ushqimit e nxënësve
Ekziston bashkëpunimi relevant me institucionet e bashkësive lokale për pengimin e paraqitjeve, deviante në shkollë, organizim i tribunave, ligjërimeve dhe punëtorive me tema mbrojtja nga duhani, alkooli dhe droga.	Hapësirat dhe kushtet në shkollë të adaptohen për nevojat e nxënësve me të meta fizike Të rritet kujdesi për zhvillimin intelektual, social dhe emocional të nxënësve

<b><i>Analiza e lëmisë 4</i></b>	<b>Mësimi dhe ligjërimi</b>
<i>Indikator i cilësisë 4.2</i>	Shëndeti
<i>Tema</i>	Higjiena dhe kujdesi nga sëmundjet
	Kujdesi për nxënësit me problemet shëndetësore
<i>Shkolla:</i>	SHMK Gjimnazi “ <b>Sami Frashëri</b> ” Kumanovë
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>	<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Shkolla posedon numër të mjaftueshëm të korpave për mbeturina	Higjiena nëpër shkolla nuk është në nivel të mjaftueshëm dhe jorregullisht sigurohen mjete për ta mirëmbajtur
Në shkollë rregullisht organizojnë vaksinimin e nxënësve dhe kontrollimet sistematike për nxënësit dhe të punësuarit	Numër i vogël i shkollave kanë program për preventimin e sëmundjeve ngjitëse
Në shkollë realizohen projekte, marrin pjesë në tribuna, ligjërime dhe punëtori në temat aktuale nga mbrojtja e sëmundjeve ngjitëse	Nëpër shkolla mungojnë procedura të shkruara për përkujdesjen e nxënësve të cilëve një kohë të gjatë kanë munguar nga mësimet

Ekziston bashkëpunimi mes shkollave, prindërve, bashkësive lokale, institucioneve relevante (qendrave shëndetësore, qendra për punë sociale)	Të përmirësohet higjiena në shkollë  Rregullisht të sigurohen kushte për mbrojtjen e higjienës
Udhëzime për tejkalimin e anëve të dobëta:	Të përpilohet plani preventiv nga sëmudjet ngjitëse  Të përgatiten procedura të shkruara për kujdesin e nxënësve të cilët një kohë të gjatë mungojnë nga procesi edukativo-arsimor

<b>Analiza e lëmisë 4</b>	<b>Përkrahja e nxënësve</b>	
<i>Indikatori i cilësisë 4.3</i>	Ndihmat për këshillime për shkollimin e mëtutjeshëm	
<i>Temat:</i>	Dhënia e ndihmës për zgjedhjen e profesionit/institucionet për arsimimin e mëtutjeshëm, përsosmëria ose punësimi	
	Kujdesi për nxënësit me pengesa emocionale	
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi “Sami Frashëri” Kumanovë	
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>		<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Nëpër shkolla duhet të jepet ndihma adekuate për arsimimin e mëtutjeshëm të nxënësit		Për realizimin e detyrave praktike një numër i vogël i shkollave, nxënësit shfrytëzojnë veshje mbrojtëse
Ekziston bashkëpunim ndërmjet shërbimeve profesionale dhe agjencionit për punësim dhe ndërmjet orientimit profesional të nxënësve i ndihmohet në orientim profesional		Në numër të madh të shkollave ekzistojnë mangësi në procedurat për kujdesje dhe procedura për identifikimin e nxënësve me pengesa emocionale

Në numër të madh të shkollave sigurohen informacionet më të reja për mundësite e perfeksionimit të mëtutjeshëm në arsim dhe punësim	
Përmes organizimeve të aktiviteteve vetanake, dhe shfrytëzimi i materialeve promotive nga institucionet e arsimit, sigurohet ndihmë profesionale për orientimin e nxënësve	Në realizimin e punës praktike në shkollë, nxënësit të përdorin veshjet mbrojtëse
Udhëzime për tejkalimin e anëve të dobëta:	Të përgatiten procedura të shkruara për kujdesjen dhe procedura për identifikimin e nxënësve me probleme emocionale

<b>Analiza e lëmisë 4</b>	<b>Përkrahja e nxënësve</b>
<i>Indikatori i cilësisë 4.4</i>	Përcjellja e përparimit
<i>Temat:</i>	Mbajtja e evidencës për punësimin individual të nxënësve
	Analiza e përparimit të nxënësve nëpër paralele
<i>Shkolla</i>	SHMK Gjimnazi "Sami Frashëri" Kumanovë
<b><i>Konstatimi i anëve të forta</i></b>	<b><i>Konstatimi i anëve të dobëta</i></b>
Numër i madh i arsimtarëve mbajnë evidencë të rregullt dhe të plotë për arritjet, vijueshmëritë dhe sjellja të çdo nxënës	Rezultatet nga analizat, përparimi nëpër klasa dhe të çdo nxënësi, shumë pak shfrytëzohen për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor.
Ekziston bashkëpunim ndërmjet shërbimit profesional, arsimtarët kujdestarë dhe të lëndëve, prindërve për përcjelljen e përparimit të nxënësve	



Arsimtarët përgatitin raport të rregullt dhe analiza, sipas periodave për klasën e vet në bazë të evidencës individuale të nxënësve	
Përgatitja e raporteve dhe analizave jepen në mbikqyrje të shërbimit profesional dhe kuadrit udhëheqës dhe të jenë të kapshme për të gjitha strukturat e shkollës	
Udhëzime për tejkalimin e anëve të dobëta:	Rezultatet nga analiza për përparim nëpër paralele dhe për çdo nxënës të shfrytëzohen për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor.

**MJETET E LËMISË:****5. KLIMA NË SHKOLLË****INDIKATORËT PËR KUALITET**

- 5.1 Klima në shkollë dhe raportet në shkollë**
- 5.2 Promovimi i të arriturave**
- 5.3 Barabarësia dhe rregullsia**
- 5.4 Partneriteti më prindërit dhe me qeverisjen lokale**

***Digasteri në kuadër të lëmisë dhe indikatorët e kualitetit:***

Atmosfera në shkollë

- Atmosfera dhe relacionet në shkollë
- Promovimi i të arriturave
- Barabarësia dhe të drejtat
- Bashkëpunimi me prindër dhe vetëqeverisje lokale

Gjatë grumbullimit të të dhënave janë shqyrtuar dokumentacionet:

- Kodi i sjelljes
- Statuti i shkollës
- Raportet dhe analizat nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit të Arsimitarëve
- Proces-verbalet nga mbledhjet e mbajtura prindore
- Verifikimi i rezultateve të punës së shkollës për vitin shkollor 2022/2023 dhe 2023/2024
- Ditaret e paraleleve
- Plani dhe programi për mësim plotësues dhe shtues
- Diplomat, lavdëratat, shpërblimet, për vlerësimet e nxënësve dhe

mësimdhënësve

- Fotografitë
- Anketat e realizuara ndër nxënës

### ***Konkluzionet***

- Në shkollë mbretëron komunikim reciprok nxënës-mësimdhënës
- Një numër i vogël i nxënësve manifestojnë sjellje negative ndaj nxënësve tjerë dhe mësimdhënësve
- Bisedohet mbi respektimin e rregullave dhe shqiptimin e masave pedagogjike nga kujdestarët e klasave, bashkëpunëtorët profesional, Këshillit të Arsimitarëve etj, varësisht nga pesha e problemit.
- Realizohet mësimi plotësues dhe shtues
- Organizohen aktivitete tjera mësimore dhe jashtëmësimore
- Kontaktet dhe takimet me prindërit realizohen me biseda telefonike dhe mbledhje prindore
- Ekziston bashkëpunim i shkollës me Ministrinë e Arsimit, Byronë për zhvillim të Arsimit, Administratat lokale, Ministrinë e punëve të Brendshme, Organizatat joqeveritare
- Bashkëpunim i shkollës me shkollat tjera nga komuna por edhe jashtë saj ku realizohen aktivitete të ndryshme të lëmive të ndryshme

### ***Rezultatet dhe analiza nga anketat e realizuara me nxënës***

1. A mendoni se ka diskriminim gjinor ndër nxënës, nga ana e mësimdhënësve ?

a) po

b) jo

c) ndonjëherë

2. Shkollën, në të cilën mësoni, a do t'ia kishit preferuar familjarëve dhe miqve tuaj?

a) po

b) jo

c) ndonjëherë

3. A ekziston bashkëpunim në shkollë mes subjekteve : mësimdhënës – nxënës, mësimdhënës – prind, nxënës-nxënës

a) po

b) jo

c) ndonjëherë

4. A informohen gradualisht nxënësit mbi përparimin e tyre – vlerësimin publik

a) po

b) jo

c) ndonjëherë

5. A keni mbështetje nga mësimdhënësit si dhe nga shërbimi profesional i shkollës?

a) po	b) jo	c) ndonjëherë
-------	-------	---------------

Në pyetjen 1:

- a) Pozitivisht – 7%
- b) Negativisht – 63%
- c) Ndonjëherë – 25%

Në pyetjen 2:

- a) Pozitivisht – 82%
- b) Negativisht – 2%
- c) Ndonjëherë – 16%

Në pyetjen 3:

- a) Pozitivisht – 52%
- b) Negativisht – 14.66%
- c) Ndonjëherë – 33.33%

Në pyetjen 4:

- a) Pozitivisht – 56.33%
- b) Negativisht – 10.33%
- c) Ndonjëherë – 33.33%

Në pyetjen 5:

- a) Pozitivisht – 50%
- b) Negativisht – 8.33%
- c) Ndonjëherë – 41.66%

<b><i>Analizë e lëmisë 5</i></b>	<b>Klima shkollore</b>
<i>Tregues i kualitetit 5.1</i>	Klima shkollore dhe raportet shkollore
<i>Temat:</i>	Pamja/imazhi i shkollës
	Kodeksi i sjelljes
	Klima shkollës
	Sjellja dhe disiplina në shkollë
